



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

## **R R E G U L L O R E**

**Nr. 5    Datë 23. 12. 2008**

**PËR**  
**DHËNIEN E AUTORIZIMIT**  
**“PËR STACIONET RADIO BREGDETARE”**

*Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.522, Datë 23.12.2008*  
*Ndryshuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2255 Datë 23.01.2013*

## **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i rregullores është të sigurohet ofrimi i shërbimit të komunikimeve nga stacionet radio bregdetare për stacionet radio të anijeve, sipas rregullave të percaktuara këtu dhe të harmonizuara me rregullat dhe normat ndërkombëtare të rekomanduara nga ITU dhe Konventa SOLAS.

## **Neni 2 Objekti**

Objekti i rregullores është publikimi i kritereve dhe procedurës që zbaton Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për dhënien e autorizimit “ Mbi ofrimin e shërbimit të stacioneve radio bregdetare” dhe mënyrën e formimit dhe caktimit të shënjes së thirjes.

## **Neni 3 Baza ligjore**

1. AKEP, nxjerr këtë rregullore në mbështetje të germës p) dhe t) të nenit 8 dhe pikës 6 të nenit 64 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918) i ndryshuar, si dhe Strategjinë “Për shërbimin e Radiondërlidhjes detare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 370, datë 05.06.2003 (**VKM Nr. 370**).
2. Dispozitat e karakterit teknik të rregullores bazohen në ligjin nr. 9918, VKM Nr. 370, Rekomandimet e ITU dhe Konventën SOLAS për këtë qëllim.
3. Dispozitat procedurale dhe administrative bazohen në frymën dhe përcaktimet e parashikuara në ligjin nr. 9918.

## **Neni 4 Detyrimi për autorizim**

1. Subjektet të cilët kërkojnë të instalojnë stacione radio bregdetare dhe nëpërmjet tyre të bëjnë të mundur ofrimin e shërbimit për stacionet radio të anijeve, janë të detyruar të pajisen me autorizim të posaçëm për instalimin dhe përdorimin e stacionit radio bregdetar. Ky autorizim lëshohet nga AKEP.
2. Stacionet radio bregdetare, sipas veprimtarisë që kryejnë pajisen me autorizimin përkatës si më poshtë:

### **a) Autorizim për shërbime ndërkombëtare**

Autorizimi për shërbime ndërkombëtare jepet për stacionet bregdetare të porteve me qëllim sigurimin e komunikimeve lidhur me operimet portuale dhe lëvizjen e anijeve. Ky autorizim mbulon vetëm stacionin bregdetar. Mjetet lundruese, të cilave u ofrohet shërbim nga ky stacion bregdetar, duhet të pajisen me licenca për stacion radio anijeje. Në këtë rast përdoren kanale ndërkombëtare të komunikimeve të destinuara për shërbimin e lëvizshëm detar dhe si rrjedhim operimi i këtij stacioni duhet të bëhet nga një

person i pajisur me çertifikatën e operatorit radiodetar, ose nën mbikqyrjen e një personi të pajisur me çertifikatën e operatorit radiodetar. Stacionet radio bregdetare mund të interkonektohen me rrjetin publik telefonik për të realizuar komunikimin ndërmjet anijeve dhe përdoruesve të rrjeteve telefonike tokësore.

#### **b) Autorizim për shërbim kombëtar**

Autorizimi për shërbime kombëtare jepet për subjektet që komunikojnë me mjetet e tyre të lëvizshme për çështje tregtare duke përdorur një kanal radio detar privat. Kanalet e dhëna për këtë shërbim janë kanale detare kombëtare dhe si rrjedhim nuk kërkojnë përdorues të pajisur me çertifikatën e operatorit radiodetar.

Stacionet radio bregdetare mund të interkonektohen me rrjetin publik telefonik për të realizuar komunikimin ndërmjet anijeve dhe përdoruesve të rrjeteve.

#### **c) Autorizim për shërbime “Klub lundrimi”**

Autorizimi jepet për shërbimin që u ofrohet klubeve të lundrimit, jahteve ose organizatave të ngjashme me qëllim sigurimin e komunikimeve që kanë të bëjnë me lëvizjen dhe ankorimin e mjeteve lundruese për qëllime argëtimi. Në këtë rast, janë të disponueshme tre kanale, të cilat janë unike për këtë lloj autorizimi. Dy prej tyre janë kanale kombëtare simplekse. Meqenëse këto kanale radiodetare nuk janë ndërkombëtare, përdoruesi nuk detyrohet të pajiset me çertifikatën e operatorit radiodetar.

Autorizimi mund të përmbajë si opsion përdorimin e një kanali për komunikime ndërkombëtare. Në këtë rast, operatori i pajisjes radio te stacionit duhet të jetë i pajisur me çertifikatën e operatorit radiodetar.

#### **d) Autorizime të përkohshme**

Në rastet e mbulimit me shërbim të aktiviteteve të përkohshëm, AKEP lëshon edhe autorizime të përkohshme për kategoritë b) dhe c) të mësipërme. Autorizimet e përkohshëm janë të vlefshme për një periudhë kohe deri në tre muaj.

### **Neni 5 Formulari i aplikimit**

1. Subjekti që kërkon të pajiset me autorizim për përdorimin e stacioneve radio bregdetar duhet të aplikojë online sipas formularit të aplikimit të përcaktuar në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje, i cili shoqërohet me tabelën mbi të dhënat teknike dhe deklaratën e pronarit/personit përgjegjës.
2. Formulari i aplikimit online plotësohet tek Moduli i Aplikimit Online për Autorizim “Për stacionet radio bregdetare” në faqen web të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al)

### **Neni 6 Dhënia e autorizimit**

1. Autorizimi i jepet të interesuarit brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e depozitimit në AKEP të Formularit të aplikimit të dërguar online në përputhje të plotë me kërkesat e

- përcaktuara në këtë rregullore dhe, pasi të ketë kryer pagesat përkatëse pas njoftimit të AKEP për tëheqjen e autorizimit të miratuar.
2. Kur AKEP konstaton parregullsi në plotësimin e Formularit të aplikimit të dërguar online, i kërkon subjektit rregullimin e tyre brenda një periudhe prej 5 (pesë) ditësh pas marrjes së njoftimit online për parregullsitë e konstatuara.
  3. Trajtimi i kërkesës online bëhet nga Drejtoria përkatëse në AKEP dhe autorizimi lëshohet i nënshkruar nga Kryetari.
  4. Formulari i aplikimit online nënshkruhet nga subjekti në momentin e tërheqjes së Autorizimit dhe i bashkëngjitet praktikës që arkivohet në AKEP.

### **Neni 7** **Shenja e thirrjes**

1. Stacionit radio bregdetar i caktohet shenja e thirrjes në përputhje me rregulloret ndërkombëtare të ITU-së.
2. Shenja e thirrjes përcaktohet për stacionet radio bregdetar që autorizohen për herë të parë nga AKEP dhe është unike për çdo stacion.
3. Shenja e thirrjes i mbetet stacionit radio bregdetar për aq kohë sa nuk ndryshohet pronari apo emri i stacionit.
4. Shenja e thirrjes dorëzohet në AKEP kur stacioni nuk zhvillon aktivitet për një periudhe 2 ose më shumë vjet.
5. Shenja e thirrjes nuk transferohet midis stacioneve radio bregdetare.

### **Neni 8** **Formimi i shenjës së thirrjes**

1. Sipas përcaktimit të seksionit III, të Radio-Rregullores së ITU shenjat e thirrjes të stacionit fikse dhe në tokë formohen si vijon:
  - a) Shenja e thirrjes për stacionet që kryejnë shërbime kombëtare:
    - dy karaktere dhe një shkronjë ose
    - dy karaktere dhe një shkronjë e ndjekur nga jo më shumë se tre numra (me përjashtim të numrave 0 dhe 1 në rastet kur ato vijojnë menjëherë mbas një shkronjë)

Megjithatë, është e rekomandueshme që, sa më shumë të jetë e mundur, shenjat e thirrjes e stacioneve fikse të konsistojnë në:

- b) dy karaktere dhe një shkronjë e ndjekur nga 2 numra (me përjashtim të numrave 0 dhe 1 në rastet kur ato vijojnë menjëherë mbas një shkronjë).

Dy karakteret e para ose në disa raste karakteri i parë i shenjës së thirrjes përfaqëson identifikimin e shtetit. Sipas Radio-rregullores së ITU identifikimi i stacioneve shqiptare për shërbime ndërkombëtare zgjidhet në serinë ZAA - ZAZ.

2. Sipas përcaktimit të seksionit IV, të nenit 19, të Radio-Rregullores së ITU shenjat e thirrjes të stacionit bregdetar që përdorin vetëm radiotelefoni formohen si vijon:
  - c) shenjën e thirrjes, sipas pikes 1, a) të mësipërme ose

- d) emrin gjeografik të vendit siç është paraqitur në Listën e Stacioneve Bregdetare, që botohet nga ITU, i ndjekur nga një fjale Radio ose nga çdo tregues tjetër i përshtatshëm (p.sh. “Durrës Radio”).

### **Neni 9 Regjistrimi**

AKEP, regjistron stacionet radio bregdetare në një regjistër i cili publikohet në faqen e internetit dhe përmban këto të dhëna:

- a) të dhënat mbi autorizimin (nr., data, vlefshmëria etj);
- b) pronarin e stacionit (sh.p.k/sh.a/person fizik);
- c) emrin e stacionit;
- d) orarin e shërbimit;
- e) shenjën e thirrjes;
- f) të dhënat për personin e kontaktit;

### **Neni 10 Çregjistrimi**

1. Çregjistrimi bëhet nëpërmjet njoftimit online për rastet kur:
  - (a) Stacioni bëhet i papërdorshëm,
  - (b) Stacioni është jashtë shërbimit, për një kohë 2 ose më shumë vjet.
2. Mbajtësi i autorizimit ka detyrim të njoftojë AKEP-in për rastet e mësipërme.

### **Neni 11 Informimi në ITU**

AKEP, bazuar në Dispozitën 20.16 të Radio-Rregullores informon ITU mbi subjektet e regjistruara (autorizuara) apo çregjistruara.

### **Neni 12 Kërkesat teknike**

1. Pajisjet e stacionit radio bregdetar duhet të jenë në përputhje me standartet dhe rekomandimet përkatëse të institucioneve ndërkombëtare të njohura e pranuar nga AKEP dhe të zbatueshme në Shqipëri.
2. Frekuencat apo kanalet e punës që do të përdoren nga stacionet radio bregdetar do të jenë ato të përcaktuara nga ITU për shërbimin e lëvizshëm detar, si dhe ato që do të caktohen nga AKEP për shërbimet kombëtare.
3. Stacionet radio bregdetar duhet të përmbushin normat teknike dhe të mos u krijojnë interferenca rrjeteve të tjera.

### **Neni 13 Detyrimi financiar për shërbimet**

1. Shlyerja e pagesave për shërbimet e ofruara nga stacioni radio bregdetar, kryhet nga

Autoriteti i Llogarive Detare, sipas kontratës së lidhur me pronaret e anijeve të cilëve u ofrohet shërbim nga stacioni radio bregdetar.

#### **Neni 14**

#### **Përdorimi i stacionit radio bregdetar**

1. Në rastin e përdorimit të frekuencave ndërkombëtare, personi përgjegjës për stacionet radio bregdetar, duhet të jetë i pajisur ose të vëzhgohet nga dikush që është i pajisur me Çertifikatën e Operatorit Radio Detar.
2. Pronari ose përgjegjësi i stacionit duhet të sigurojë sekretin e informacioneve të marra gjatë shërbimit të radiokomunikacionit.
3. Rregullat e komunikimit janë të përcaktuara në Radio-Rregulloren përkatëse të ITU.

#### **Neni 15**

#### **Modifikimi i Autorizimit**

1. Modifikimi i autorizimit bëhet me kërkesën online të subjektit, në rastet kur:
  - (a) ndryshon emri stacionit,
  - (b) kërkohet të ndryshohen ose shtohen pajisjet radio,
  - (c) çdo ndryshim tjetër në të dhënat e autorizimit.
2. I autorizuari është i detyruar të njoftojë online në AKEP për të gjitha ndryshimet në të dhënat e deklaruara në formularin e aplikimit.

#### **Neni 16**

#### **Detyrimet Financiare**

1. Subjekti, me marrjen e njoftimit online nga AKEP për miratimin e autorizimit të kërkuar, është i detyruar që të paguajë detyrimet financiare të parashikuara për autorizimin në përputhje dhe zbatim të legjislacionit në fuqi, akteve nënligjore dhe rregullave të përcaktuara nga AKEP.
2. Mënyra, niveli dhe afati i pagesave në referencë pikën 1 të këtij neni, publikohen nga AKEP dhe i bashkëngjiten kësaj rregulloreje në formë aneksi.

#### **Neni 17**

#### **Vlefshmëria e autorizimit dhe rinovimi**

1. Autorizimi i lëshuar sipas kësaj rregulloreje është i vlefshëm për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të tij.
2. Për rinovimin e autorizimit, subjekti i drejtohet AKEP-it duke dërguar online kërkesën 30 ditë para përfundimit të vlefshmërisë së tij, duke paraqitur dhe ndryshimet, nëse ka të tilla.

#### **Neni 18**

#### **Sanksionet**

1. Është i ndaluar përdorimi i stacioneve radio bregdetare pa qenë i pajisur nga AKEP

me autorizim sipas kësaj rregulloreje.

2. Për shkelje të ligjit nr. 9918 i ndryshuar, kushteve të autorizimit dhe kërkesave të rregullores, nëse nuk përbëjnë vepër penale AKEP zbaton sanksionet e parashikuara në nenin 76, 134, 135 dhe 137 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar.

### **Neni 19** **Dispozita të tjera**

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi datën e miratimit të saj nga KD i AKEP.
2. Çdo ndryshim i mundshëm i Rregullores do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe vendimet e rekomandimet e ITU të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

**Miratuar me Vendim Nr. 522 Datë 23.12.2008 të Këshillit Drejtues të AKEP,**  
ndryshuar me Vendim Nr 2255 datë 23.01.2013, të Këshillit Drejtues të AKEP.

**FORMULAR APLIKIMI ONLINE  
PËR  
PAJISJEN ME AUTORIZIM PËR STACIONET RADIO BREGDETAR  
NDËRKOMBËTAR/KOMBËTAR/KLUB LUNDRIMI**

<input type="checkbox"/>	Aplikim për autorizim
<input type="checkbox"/>	Rinovimi i autorizimit egzistues

<input type="checkbox"/>	Ndryshimi i të dhënave
<input type="checkbox"/>	Nderprerje aktiviteti/veprimatit (Çregjistrim)

**1. Të dhënat e subjektit:**

1.1	Emri i Personit (juridik/fizik) (Pronari i Stacionit)	
1.2	Adresa Postare	
1.3	Telefon/Faks	
1.4	E-mail	
1.5	Data e Regjistrimit në QKR	
1.6	NIPT-i	
1.7	Emri i përfaqësuesit ligjor	
1.8	Numri personal sipas dokumentit të identifikimit - ID	
1.9	Emri i Stacionit	
1.10	Shenja e Thirrjes (nëse është caktuar me parë)	
1.11	Porti i Regjistrimit	
1.12	Orari i shërbimit (punës) të stacionit	

**2. Te dhena mbi frekuencat qe kerkohen:**

2.1	Brezi i Frekuencave	Fillimi:	Mbarimi:
2.2	Frekuencat e punës:	Tx:	Rx:
2.3	Tipi i Modulimit:		
2.4	Gjerësia e Brezitet:		
2.5	Kapaciteti i Lidhjes (Mbps):		
2.6	Marka dhe tipi i transmetuesit, marrësit:		
2.7	Antena:	Tipi:	Përforcimi : Polarizimi:
2.8	Fuqia në dalje të pajisjes :		

**3. Vendndodhja dhe të dhënat e Zonës së Mbulimit**

3.1	Zona e Veprimit (Traseja Tx – Rx)		
3.2	Kordinatat Gjeografike të Tx	N:	Ë:
3.3	Lartësia nga Niveli i Detit (metra)		
3.4	Lartësia nga Toka (metra)		



3.5	Kordinatat Gjeografike të Rx	N:	Ë:
3.6	Lartësia nga Niveli i Detit (metra)		
3.7	Lartësia nga Toka (metra)		

**4. Koha që kërkohet për përdorimin e frekuencave:**

**5. Paraqitni më poshtë Arsyet dhe Qëllimin e Përdorimit të frekuencave të kërkua më sipër.**


*Shënim: Nëse kërkohen përdorimi i disa pajisjeve radio, tabelat e pikës 2 dhe 3, të paraqiten të plotësuar në vijim, për çdo pajisje më vete.*

Në rast se formulari i aplikimit online paraqitet i plotësuar nga një person i autorizuar, autorizimi për këtë person duhet të shoqërojë formularin e aplikimit.

Emri, Mbiemri  
Nënshkrimi dhe Vula

Data: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Vendi: \_\_\_\_\_

## **DEKLARATË E PRONARIT/PERSONIT TË AUTORIZUAR**

Nën përgjegjësi të plotë ligjore, deklaroj se të dhënat, dëshmitë dhe informacioni i paraqitur në formularin e aplikimit online dhe çdo lidhje të tij janë të vërteta, të sakta dhe në përputhje me çdo kërkesë të parashikuara ligjërisht mbi përgjegjësinë e vetëdeklarimit.

Me marrjen e autorizimit deklaroj se do të zbatoj :

1. Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar dhe aktet nën ligjore të fushës;
2. Kushtet e autorizimit;
3. Kërkesat e rregullores për dhënien e autorizimit “Për stacionet radio bregdetare”

---

(firma, vula)

---

(emri, mbiemri)

---

(pozicioni)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 9918, DATË 19.05.2008**  
**“PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**  
**I NDRYSHUAR**

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**PAJIS ME**

**AUTORIZIM**

**SUBJEKTIN**

**” \_\_\_\_\_ ” SH.P.K/SH.A/PERSON FIZIK**

**Për përdorimin e Stacionit Radio Bregdetar**  
**me**  
**Shenjë Thirrje \_ \_ \_ \_**

**SIPAS RREGULLAVE TË MIRATUARA ME VENDIM TË KËSHILLIT DREJTUES**  
**TË AKEP NR. \_\_\_ DATË \_\_/\_\_/\_\_\_.**

**DATA E HYRJES NË FUQI \_\_.\_\_.\_\_\_\_\_.**

**I VLEFSHËM DERI MË \_\_.\_\_.\_\_\_\_\_.**

# **AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE – AKEP**

## **Stacioni Radio Bregdetar “ \_\_\_\_\_ ”**

### **1. Të dhënat e sipërmarrësit të autorizuar:**

1.1	Emri i pronarit të autorizuar (person fizik, shpk,sha)		
1.2	Adresa Postare		
1.3	Telefon/Faks/E-mail		
1.4	Personi i Kontaktit		
1.5	Data e regjistrimit në QKR		
1.6	NIPT-i		

### **2. Të dhëna mbi frekuencat e caktuara:**

2.1	Brezi i Frekuencave	Fillimi:	Mbarimi:
2.2	Frekuencat e punës:	Tx:	Rx:
2.3	Tipi i Modulimit:		
2.4	Gjerësia e Brezit:		
2.5	Kapaciteti i Lidhjes (Mbps):		
2.6	Marka dhe tipi i transmetuesit, marrësit:		
2.7	Antena:	Tipi:	Përforcimi : Polarizimi:
2.8	Fuqia në dalje të pajisjes (Ë):		

### **3. Vendndodhja dhe të dhënat e Zonës së Mbulimit**

3.1	Zona e Veprimit (Traseja Tx – Rx)		
3.2	Kordinatat Gjeografike të Tx	N:	Ë:
3.3	Lartësia nga Niveli i Detit (metra)		
3.4	Lartësia nga Toka (metra)		
3.5	Kordinatat Gjeografike të Rx	N:	Ë:
3.6	Lartësia nga Niveli i Detit (metra)		
3.7	Lartësia nga Toka (metra)		

### **4. Koha e Vlefshmërisë së këtij Autorizimi**

4.1	Koha e Vlefshmërisë	Data e hyrjes në fuqi:	Data e mbarimit:
-----	---------------------	------------------------	------------------

**KRYETARI**

\_\_\_\_\_  
(emri, mbiemri, firma, vula)